



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 900-10745

Dt: 25.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, Përfundimit 01. Nr. 06-9885-5/2 të miratuar në mbledhjen Bordit të Drejtorëve të dt. 24.02.2016, më të cilën u miratua kërkesa e Organizatës e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative të kësaj shoqate, me dt: 25.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Organizatës e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë, e evidentuar me nr. 01-400-7947 e dt: 11.02.2016, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbarëvajtjen dhe për mbulimin e shpenzimeve operative, duke e mbështetur me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 3,050.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,050.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e Organizatës e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë, nr. 1704-0010-110190.36 NLB Bank.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyrës së Kryetares së Komunës
- Z. Sadri Hoxha, kryetar i Organizatës së luftës së UÇK-së – dega në Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

